

## TERMA REFERENCE

**EKSPERT MODERATOR NË OPEN FORUME ME OBJEKTIV NDËRGJEGJËSIMIN E TË RINJVE MBI INTEGRITETIN E ZGJEDHJEVE DHE PROCESIN E DEKRIMINALIZIMIT ME NË FOKUS RRETHET KUKËS DHE LEZHË.**

<b>Pozicioni / Shërbim</b>	Moderator në open forume me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve mbi integritetin e zgjedhjeve dhe procesin e dekriminalizimit me në fokus rrethet Kukës dhe Lezhë.
<b>Titulli i Projektit</b>	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”
<b>Mbështetur:</b>	Projekti financohet nga Ambasada Britanike në Shqipëri
<b>Lloji i Kontrates :</b>	Kontratë shërbimi – Moderator në open forume
<b>Periudha e kontratës</b>	Shkurt 2024
<b>Ditë pune</b>	1 ditë pune

### **Informacion i përgjithshëm për Projektin**

- Projekti ka për qëllim të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin zgjedhor.
- Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në

zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

### **Qëllimi i shërbimit**

Në kuadër të implementimit të “*Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike*”, Instituti i Studimeve Politike kërkon moderator në open forumet që do të organizohen në rrethet Kukës dhe Lezhë me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve mbi integritetin e zgjedhjeve dhe procesin e dekriminalizimit.

Moderatori i kontraktuar nga ISP do të moderojë forumet/debatet e hapura për temën:

Integriteti, transparenca dhe llogaridhënia

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e moderatorit:**

- Lehtësimi dhe moderimi i debateve në qytetet e paracaktuara nga projektit;
- Të hartojë përmbajtjen e debateve në tematikat e caktuara;
- Përgatit një raport narrativ mbi angazhimin e të rinjve, rezultatin e debateve dhe disa përfundime dhe rekomandime;
- Merr pjesë në takimet e projektit nëse kërkohet
- Të mundësojë dorëzimin e timesheet-eve, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqëruar që do të duhet për raportimin e shërbimit;
- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

### **Profili i moderatorit:**

- Diplomuar në nivelin Master Profesional/Shkencor për Shkenca Politike, Juridike, Sociale apo Shkenca Komunikimi;
- Eksperienca të mëparshme bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- Njohës i legjislacionit zgjedhor dhe i ligjit të dekriminalizimit.

### **Aftësitë individuale:**

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip dhe jo vetëm;
4. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura.

### **Dokumentet e Aplikimit:**

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar
2. Ofertë Financiare e nënshkruar në GBP

### **Kostot dhe Pagesat**

Kosto totale për sigurimin e këtij shërbimi për gjithë periudhën parashikohet të jetë 200 GBP (dyqind) bruto. Mënyra e pagesës përcaktohet në Kontratën e Shërbimit pas punës së kryer.

Aplikimi duhet të dërgohet në një nga 3 variantet, për open forume në Kukës jo më vonë se data 07/02/2024 ora 16:00 dhe për open forume në Lezhë jo më vonë se data 12/02/2024 ora 16:00

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit [contactaips@gmail.com](mailto:contactaips@gmail.com),
2. **Me postë** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*ISP\_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike – moderator në open forume Kukës dhe Lezhë. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë
3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*ISP\_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike - moderator në open forume Kukës dhe Lezhë. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

*(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)*

**Instituti i Studimeve Politike**